



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1749 Prot

Tiranë, më 12.12.2019

**V E N D I M**

Nr.180, datë 12.12.2019

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Selenicë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Selenicë,

**VËREJ SE,**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me Urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Selenicë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Selenicë, me Vendimin nr. 94, datë 21.12.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të

Bashkisë Selenicë dhe njësisive administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë Selenicë ka nxjerrë Urdhrin nr. 1132/1 prot., datë 02.05.2019, “Mbi strukturën organike për vitin 2019 dhe nivelin e pagave të punonjësve”. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Selenicë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **57** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **7** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese; **29** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **21** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, **26** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **30** pozicione të shërbimit civil, rezulton se, aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **1** pozicion i shërbimit civil rezulton vend vakant.

Konkretisht, në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, përfshihen **30** punonjës, të cilët janë evidentuar si më poshtë, sipas aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit”, në Drejtorinë e Planifikimit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me kontratën individuale të punës nr. 469 prot., datë 16.03.2016.
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin e Mjedisit, në Drejtorinë e Planifikimit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Selenicë, me kontratën individuale të punës nr. 470 prot., datë 16.03.2016.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Specialist Veteriner”, me Urdhrin nr. 473 prot., datë 16.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë.
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Pyjeve dhe Kullotave”, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Selenicë, me Urdhrin nr.14, datë 01.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë.
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor i emergjencave civile”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me Urdhrin nr. 467 prot., datë 16.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë.
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Selenicë, me kontratën individuale nr. 93, datë 16.01.2017.
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Taksash”, në njësinë administrative Kotë, me kontratën individuale të punës datë 01.03.2014.

8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Turizmi*”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 7, datë 27.04.2016.
9. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë Shërbimeve, me aktin nr. 6, datë 27.04.2016.
10. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*IT*”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 4, datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin nr. 17, datë 01.02.2018, “*Për ndryshim pozicioni të punës*” është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës IT*”, në Bashkinë Selenicë.
11. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Finance*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 14, datë 27.04.2016.
12. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Finance*”, në njësinë administrative Vllahinë, me aktin nr. 5, datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin “*Transferim kuadri*”, nr. 74, datë 07.06.2018, është emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Selenicë.
13. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Bujqësie*”, në Drejtorinë e Bujqësisë, me aktin nr. 8, prot., datë 27.04.2016.
14. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Arkiv Protokollit*”, në njësinë administrative Armen, me aktin nr. 13, prot., datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin “*Transferim kuadri*”, nr. 18, datë 01.02.2018, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Arkivës dhe Protokollit*”, në Bashkinë Selenicë.
15. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Arkiv Protokoll*”, në njësinë administrative Vllahinë, me aktin nr. 3, datë 27.04.2016.
16. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Arkitekt*”, në Drejtorinë Planifikimit të Territorit, me aktin nr. 5, datë 03.10.2016.
17. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Drejtor Arsimit Kulturës*”, në Bashkinë Selenicë, me aktin nr. 8, datë 03.10.2016.
18. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Jurist*”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me aktin nr. 1, datë 17.01.2017.
19. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Jurist*”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me aktin nr. 2, datë 03.10.2016.
20. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Arsimit*”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 14, datë 17.10.2016.
21. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Finance*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 4, datë 03.10.2016.
22. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Finance*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 3, datë 03.10.2016. Aktualisht, me aktin “*Për ndryshim pozicioni të punës*”, nr. 75, datë 07.06.2018, është emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Selenicë.
23. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 3 datë 30.04.2018.
24. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës, “*Inspektor Bujqësie*”, në Drejtorinë e Bujqësisë, me aktin nr. 1, datë 30.04.2018.

25. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Jurist*”, në Drejtorinë Shërbimeve, me aktin nr. 2, datë 30.04.2018.
26. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, me aktin e emërimit nr. 1, datë 27.04.2016.
27. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Arsimit*”, me aktin e emërimit nr. 193/1 prot., datë 07.04.2016.
28. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë*”, me aktin e emërimit nr. 12, datë 11.10.2016.
29. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës*”, me aktin nr. 2, prot., dt. 27.04.2016. Aktualisht, me aktin e emërimit nr. 06, datë 03.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*”, në Bashkinë Selenicë.
30. \*\*\*\*\*, i cili është emëruar me urdhrin nr. 89, datë 01.03.2008, në pozicionin “*Përgjegjës Zyre Finance*”, dhe më pas me aktin e emërimit nr.9, datë 03.10.2016, është emëruar në pozicionin e punës “*Drejtor Finance*”, në Drejtorinë e Financës, në Bashkinë Selenicë, titullari i institucionit duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit në pozicionin e “*Drejtorit*”, duke e rikthyer punonjës në pozicionin ku e ka fituar statusin e punësimit, në nivelin “*Përgjegjës Sektori*”.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërej se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Selenicë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative,

ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t`u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Sa i takon strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 1132/1 prot., datë 02.05.2019, të Kryetarit të Bashkisë, e cila është në fuqi në momentin e kryerjes së inspektimit, rezulton se, kjo strukturë nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, pasi në disa njësi organizative *“Sektor”* nuk janë respektuar kërkesat e këtij aktit nënligjor, për krijimin e sektorit me të paktën një pozicion *“Shef/përgjegjës sektori”* dhe dy vartës, ose pa pozicionin e *“Shefit/përgjegjësit”*, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës, pasi në pesë raste, konkretisht, sektori *“Ndihmës Ekonomike”*, sektori *“Bashkërendimit e Koordinimit të Procesit të Integruar European”*, sektori *“Arshiv Protokollit”*, sektori *“Arsimit”* dhe sektori *“Emergjencave Civile”*, kanë një përgjegjës sektori dhe një vartës, ndërsa në një rast, sektori *“IT”* ka vetëm një pozicion përgjegjës sektori, pa vartës.

Gjithashtu, në strukturën e kësaj bashkie nuk janë përfshirë pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në njësitë administrative, që janë në varësi të Bashkisë Selenicë.

## Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **30** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të cilët janë evidentuar si më poshtë:
  1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit”, në Drejtorinë e Planifikimit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me kontratën individuale të punës nr. 469 prot., datë 16.03.2016.
  2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin e Mjedisit, në Drejtorinë e Planifikimit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Selenicë, me kontratën individuale të punës nr. 470 prot., datë 16.03.2016.
  3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Specialist Veteriner”, me Urdhrin nr. 473 prot., datë 16.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë.
  4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Pyjeve dhe Kullotave”, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, në Bashkinë Selenicë, me Urdhrin nr.14, datë 01.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë.
  5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor i emergjencave civile”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me Urdhrin nr. 467 prot., datë 16.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë.
  6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Selenicë, me kontratën individuale nr. 93, datë 16.01.2017.
  7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Taksash”, në njësinë administrative Kotë, me kontratën individuale të punës datë 01.03.2014.
  8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Turizmi”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 7, datë 27.04.2016.
  9. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Specialist”, në Drejtorinë Shërbimeve, me aktin nr. 6, datë 27.04.2016.
  10. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “IT”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 4, datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin nr. 17, datë

- 01.02.2018, “Për ndryshim pozicioni të punës” është emëruar në pozicionin “Përgjegjës IT”, në Bashkinë Selenicë.
11. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Finance”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 14, datë 27.04.2016.
  12. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Finance”, në njësinë administrative Vllahinë, me aktin nr. 5, datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin “Transferim kuadri”, nr. 74, datë 07.06.2018, është emëruar në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Selenicë.
  13. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Bujqësie”, në Drejtorinë e Bujqësisë, me aktin nr. 8, prot., datë 27.04.2016.
  14. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Arkiv Protokollit”, në njësinë administrative Armen, me aktin nr. 13, prot., datë 27.04.2016. Aktualisht, me aktin “Transferim kuadri”, nr. 18, datë 01.02.2018, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Arkivës dhe Protokollit”, në Bashkinë Selenicë.
  15. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Arkiv Protokoll”, në njësinë administrative Vllahinë, me aktin nr. 3, datë 27.04.2016.
  16. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Arkitekt”, në Drejtorinë Planifikimit të Territorit, me aktin nr. 5, datë 03.10.2016.
  17. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor Arsimit Kulturës”, në Bashkinë Selenicë, me aktin nr. 8, datë 03.10.2016.
  18. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Jurist”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me aktin nr. 1, datë 17.01.2017.
  19. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Jurist”, në Drejtorinë e Shërbimeve, me aktin nr. 2, datë 03.10.2016.
  20. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Arsimit”, në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, me aktin nr. 14, datë 17.10.2016.
  21. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Finance”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 4, datë 03.10.2016.
  22. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor Finance”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 3, datë 03.10.2016. Aktualisht, me aktin “Për ndryshim pozicioni të punës”, nr. 75, datë 07.06.2018, është emëruar në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Selenicë.
  23. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 3 datë 30.04.2018.
  24. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës, “Inspektor Bujqësie”, në Drejtorinë e Bujqësisë, me aktin nr. 1, datë 30.04.2018.
  25. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Jurist”, në Drejtorinë Shërbimeve, me aktin nr. 2, datë 30.04.2018.
  26. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, me aktin e emërimit nr. 1, datë 27.04.2016.

27. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Arsimit”, me aktin e emërimit nr. 193/1 prot., datë 07.04.2016.
28. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë”, me aktin e emërimit nr. 12, datë 11.10.2016.
29. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, me aktin nr. 2, prot., dt. 27.04.2016. Aktualisht, me aktin e emërimit nr. 06, datë 03.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar në pozicionin “Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, në Bashkinë Selenicë,

si dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, me qëllim që të plotësohen në përputhje me ligjin, nëpërmjet konkurrimit.

30. Për punonjës të \*\*\*\*\*, i cili është emëruar me urdhrin nr. 89, datë 01.03.2008, në pozicionin “Përgjegjës Zyre Finance”, dhe më pas me aktin e emërimit nr. 9, datë 03.10.2016, është emëruar në pozicionin e punës “Drejtor Finance”, në Drejtorinë e Financës, në Bashkinë Selenicë, titullari i institucionit duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit në pozicionin e “Drejtorit”, duke rikthyer punonjës të pozicionin ku e ka fituar statusin e punësimit, në nivelin “Përgjegjës Sektori”.
2. Njësia përgjegjëse të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për ato pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në të cilat mungojnë, dhe të vijojë procesi i plotësimit të pozicioneve të lira, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të paralajmërimit.
3. Njësia përgjegjëse të rishikojë dhe hartojë strukturën në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.
4. Të përmyllet procesi i mbikëqyrjes i cili është finalizuar me vendimin paralajmërues nr. 102, datë 28.12.2018, të Komisionerit, për institucionin e Bashkisë Selenicë dhe të vijojë rregullimi i ligjshmërisë sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.



Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Selenicë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Selenicë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Vlorë. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Selenicë duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**